



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk.II.nr. 295/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit "Auto Mita" SH.P.K., me NUI: 810816481 me seli në Prishtinë, adresa magjistralja Prishtinë-Shkup, kundër debitorit "Univerzal Comerc" N.T.P, me NUI: 810682791, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.551/23 të datës 03.11.2023, me datë **05.06.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit "Univerzal Comerc" N.T.P, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.551/23 të datës 03.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.551/23 të datës 03.11.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit "Univerzal Comerc" N.T.P, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.126/20 i datës 14.07.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.551/23 të datës 03.11.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Auto Mita” SH.P.K., ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm/faturave, Fatura nr. 19-SHV01-V-176 e datës 10.09.2019, Fatura nr. 19-SHV01-V-8, e datës 09.01.2019, Fatura nr. 19-SHV01-V-7, e datës 08.01.2019, duke e obliguar debitorin që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 6,908.99 €, me kamatë ligjore 8 %, duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturës e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e përmbartimit, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të dokumentit të papërshtatshëm për tu përmbartuar, duke i’u referuar ekstraktit nga librat afariste. Tutje ka shtuar se propozimi i kreditorit është pa bazë juridike dhe i jashtëligjshëm, pasi që dokumenti i besueshëm nuk është i pranuar dhe i nënshkruar-vulosur, nga debitori (vetëm fatura nr.19-SHV01-V-7 mund të identifikohet dhe është e vulosur, ndërsa dy faturat tjera nuk kanë as adresë të njejtë dhe as nuk mund të identifikohen-nuk kanë vulë pranimit). I ka propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të Përmbartuesit Privat të anulohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke theksuar se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm faturave origjinale, dhe jo ekstrakteve nga librat afariste siç pretendon debitori, të cilat përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme të parapara me ligjin për procedurën përmbartimore, i njejtë nuk përmban asnjë të metë juridike, dhe për këtë arsye i ka të gjitha tiparet e dokumentit të përmbartueshëm. Ka shtuar se propozimi i kreditorit ka qenë të lejohet përmbartimi në bazë të faturave origjinal, të cilat i përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme sipas ligjit, e të cilat janë të nënshkruara nga ana e debitorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pathemeltë prapësimi i debitorit, dhe të mbetet në fuqi Urdhri i Përmbartuesit Privat.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.551/23 të datës 03.11.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “Univerzal Comerc” N.T.P, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.126/20 i datës 14.07.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se dokumentet e besueshme - Fatura nr. 19-SHV01-V-176 e datës 10.09.2019, Fatura nr. 19-SHV01-V-8, e datës 09.01.2019, Fatura nr. 19-SHV01-V-7, e datës 08.01.2019, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili

përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbardim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”, konsideron se faturat si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, prandaj konsiderohen si dokument i besueshëm. Po ashtu, faturat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali. dhe mbanë nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit. Andaj, faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm meqenëse në të janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbardimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbardimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbardues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbardimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II nr.295/24 me datë 05.06.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami